






SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

# *Klubi i Artit & Kulturës*









**SIGAL UNIQA Shqipëri**
SIGAL Business Center
Blv: "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: (+355) 4 2233 308, Fax: (+355) 4 2250 220
e-mail: info@sigal.com.al
www.sigal.com.al




**SIGAL UNIQA Kosova**
Rr. "Vaso Pasha", p.n. Pejton, 10 000,
Prishtinë, Kosovë
Tel: (+381) 38 240 241, Fax: (+381) 38 240 241 123
e-mail: info@sigal-ks.com
www.sigal-ks.com




**UNIQA Maqedoni**
Rr. "Marks & Engels" 3, 1000
Shkup, Maqedoni
Tel: (+389) 2 3125 920, Fax: (+389) 2 3215128
e-mail: info@uniqa.mk
www.uniqa.mk

## Të dashur artdashës dhe miq të Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA,

Katër vjet më parë finalizuam dëshirën tonë për ti dhënë Durrësit, kësaj qendre të rëndësishme historike dhe kulturore, një Klub Arti dhe Kulture i cili do të ishte më shumë sesa një qendër e thjeshtë arti. Përmes ngritjes së këtij Klubi Arti ne donim të promovonim kulturën kombëtare, të rrisnim ndërgjegjen për trashëgiminë kulturore të kombit tonë dhe të punonim të gjithë së bashku për ta çuar më përpara këtë trashëgimi.

Përgjatë 15 viteve të aktivitetit sigurues të SIGAL UNIQA, kemi përkrahur vazhdimisht projekte të shumta kulturore si në zhanrin e muzikës, ashtu edhe të arteve pamore. Në simbol të dëshirës sonë për të mbështetur artin dhe kulturën në vend themeluam këtë klub, unik për nga lloji në të gjithë Shqipërinë, qëllimi i të cilit është promovimi, veçanërisht, i artistëve të rinj.

Sot, katër vjet më pas, jam i lumtur teksa shoh se Klubi ka mirëpritur qindra artistë të rinj e të afirmuar dhe ka zhvilluar aktivitete të shumta në përmbushje të qëllimit për të cilin u krijua, një përshkrim të cilave do ti gjeni në këtë broshurë.
Klubi i Artit dhe Kulturës i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është vendosur jo pa qëllim në qendër të Durrësit: në Rrugën Tregtare, një zonë e cila për nga vetë pozicionimi i saj ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rrjedhimisht edhe në atë kulturor dhe social të qytetit bregdetar. Aktualisht, Klubi i Artit dhe Kulturës është shndërruar në vendin ideal për të gjithë adhuruesit e letërsisë, muzikës, arteve pamore.

Emrat e artistëve dhe aktivitetet e shumta të zhvilluara gjatë vitit të kaluar janë në provë e rolit të Klubit në promovimin e artit dhe kulturës bashkëkohore shqiptare përmes prezantimeve të titujve të rinj letrarë, eventeve muzikore, ekspozitave të pikturës, skulpturës dhe seminareve



Avni PONARI
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

të ndryshme. Në këtë mënyrë, Klubi i Artit dhe Kulturës është përpjekur të kontribuojë në edukimin e mëtejshëm të publikut të gjerë me risitë kulturore në Durrës dhe në të gjithë Shqipërinë.

Në përvjetorin e 15 të SIGAL UNIQA dhe vitin e katërt të Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA, një risi shumë e bukur është prezantuar për publikun shqiptar: Orkestra e Harqeve e Klubit të Artit dhe Kulturës, e përbërë nga virtuozë të suksesshëm nën drejtimin e dirigjentit Ermir Dizdari, Mjeshtër i Madh.

Ju ftoj të shfletoni broshurën dhe të vizitoni Klubin e Artit dhe Kulturës në aktivitetet e tij.

**Avni PONARI**
**Drejtor i Përgjithshëm**
**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA**




## SIGAL UNIQA Group AUSTRIA inauguroi Klubin e Artit dhe Kulturës në promovim të vlerave artistike.



Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Durrës u inaugurua në 8 Nëntor 2010. Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë personalitete të jetës kulturore, ekonomike dhe politike të qytetit ndër të cilët Kryetari i Bashkisë së Durrësi z. Vangjush Dako, Deputet i qytetit të Durrësit z. Gazmend Oketa, Zv. Kryetari i Bashkisë Durres z. Zhuljen Varfaj, Drejtori i Kulturës në Bashkinë e Durrësit z.Adrian Gura si dhe përfaqesues të artit dhe kulturës në këtë qytet.



Për Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL, z. Avni Ponari i cili në vitin 2009 u shpall 'Nderi i Qytetit të Durrësit', motivi i hapjes së një Klubi Arti dhe Kulture në Durrës është i thjeshtë: vlerat e mëdha kulturore, artistike dhe historike dhe mbart ky qytet.



Nga ana e tij, kryetari i Bashkisë Vangjush Dako falenderoi SIGAL për hapjen e kësaj qendre të re kulturore si një kontribut për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit.



Klubi i Artit dhe Kulturës është vendi ideal për të gjithë ata që duan të mësojnë më tepër rreth historisë dhe kulturës së Durrësit dhe Shqipërisë, për ata që interesohen për krijimtarinë e artistëve vendas si dhe për të gjithë ata që duan të diskutojnë rreth artit dhe kulturës me miqtë e tyre dhe njerëz të artit.

Mirënjohje "Sigal-it"
Shëndet i Njeriut dhe i Artit.
Përurimet e tua janë të hershme në të mirë të Jetës e të Shpresës.
Mendimi yt bulëzon tejet i veccantë e i përveccëm.
Mirënjohje "Sigal"-përvojë e rritur shpejt.
Jetëgjatë Guximi yt,
aq jetëgjatë sa Besimi ynë tek TY.
Shpejtësia jote me dritë diturie e shembëlltyrë të re nxiton, rend,
arrin atje ku Njeriu ndihet më i respektuar,
më bujar e frytdhënës prej Mendësive të Tua...

Mirënjohje "Sigal"-
I Papërtuari,I Palodhuri...
Ne ccdo ditëlindje tënden- ne jemi të rinj,
plot kuptime të reja si "Klubi i Artit"n qytetin tonë,
i vetmi këtu e në Shqipëri,i cili dëshiron sivëllezërit e vet, simotrat...
"Klubi i Artit"- Shtëpia jonë shpirtërore plot hapësira, alfabet vargu, tingulli, e ngjyrash tejet i pranishëm e i pafundëm, tek secili, tek të gjithë
zgjon një amfiteatër të ri guximi e besimi jetëgjatë sa ty.
Mirënjohje "Sigal"-Shëndet i Njeriut dhe Artit.

I pozicionuar në qendër të Durrësit në rrugën tregtare, klubi i artit dhe kulturës, Sigal, ofron një bibliotekë të pasur me tituj të ndryshëm të letërsisë shqiptare dhe botërore, në gjuhë të ndryshme, botime akademike nga të gjitha fushat periodike të huaj e shqiptarë. Për adhuruesit e artit figurativ, janë hapur ekspozita pikture, skulpturash, fotografie e shumë të tjera të artistëve të rinj dhe atyre të afirmuar. Nga ana tjetër kqëtu do të gjeni një axhentë të mbushur me mbrëmje muzikore, muzikë dhome, koncerte me instrumentistë të ndryshëm, të cilat do t;ju japin një ëknaqësi të veccantë dhe të pamasë. Promovimet e librave të ndryshëm poetikë, vëllimet me tregime, romanet, librat historik do të përcjellin të rejat më të fundit në krijimtarinë letrare.

Tek Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL, Durrës, do të merrni ushqimin shpirtëror në të vetmin vend, ku mund të bashkoni njëkohësisht letërsinë, pikturën, historinë, tarditën dhe muzikën.

**Dirigjent, Ermir Dizdari**
**"Mjeshtër i Madh"**
**Drejtor**
**I Klubit të Artit dhe të Kulturës, SIGAL**




DREJTORIA E PËRGJITHSHME
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA,
Shqipëri

# *Klubi i Artit & Kulturës*

**Të dashur miq,**

kemi kenaqësinë të ndajmë së bashku disa momente nga viti artistik 2013-2014 i Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

Vempritarite artisiko-kulturore për vitin 2013 filluan në muajin Shkurt me festimin e përvjetorit të kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend SIGAL UNIQA Group AUSTRIA. Këto festime ishin një ogur i mirë për të gjithë muajt pasardhës gjatë të cilëve qindra njerëz kanë ndjekur nga afër aktivitetet e shumta të artistëve shqiptarë dhe të huaj të zhvilluara në ambjentet e Klubit e Artit dhe Kulturës.

**Shkurt 2013 - Shkurt 2014**

## E premte, 22 shkurt 2013, ora 17:30







**Ekspozita personale e piktores Lume Blloshmi:**

Me rastin e 14-vjetorit të kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL, u organizua ekspozita personale e piktores të mirënjohur Lume Blloshmi.

Ekspozita mbeti e hapur për të gjithë artdashësit për një periudhë 1-mujore.

**Pjesëmarrja:**

Në çeljen e ekspozitës morën pjesë përfaqësues të ekonomisë, politikës dhe artit durrsak.

Ekspozita u pasqyrua gjerësisht në mediat vizive dhe të shkruara.

Piktorja Lume Blloshmi, është një piktore e një lloji tjetër, ku spikat ekspresioni, ngjyra, tematika e larmishme. Jeta e saj ka kaluar shumë stuhi, shumë përpjekje, shumë, privime. Të gjitha këto kanë formuar tek ajo një karakter të fortë, të qëndrueshëm, largpamës të cilat ajo është munduar ti hedhë në telajo. Në pikturat e saj e sheh jetën optimiste, me ngjyra të bukura.


SIGAL







## E shtunë, 13 prill 2013, ora 19:00







**Koncert i trios akademike**
me pedagogët instrumentist të Universitetit të Arteve, Tiranë:
Fatos Qerimaj- Klarinetë,
Arben LLozi- Violë,
Merita Rexha (Tershana) - Piano.

**Programi:**
Carl Reinecke, Trio in A op. 264,
Dan Dediu – Mikrobenmusk Trio op. 36,
Max Bruch- Eigh pieces op. 83.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 60 spektatorë.
Për këtë koncert ka shkruar: Gazeta "55", Gazeta "Telegraf", Gazeta "Plus".

Trioja akademike Fatos Qerimaj (klarinetë), Arben Llozi (violë), dhe Merita Rexha Tërshana (piano), është formuar rreth 12 vjet më parë duke lenë gjurmë në muzikën shqiptare.

Në këtë koncert kjo trio e mirënjohur luajti pjesë dhome nga kompozitorë gjermanë, ku dy prej kompozimeve ishin premierë. Në sallë ishin intelektualë, muzikantë, poetë, shkrimtarë, gazetarë dhe studiues të muzikës.




SIGAL





## E enjte, 02 maj 2013, ora 18:00






**Koncert i nxënësve të Shkollës së Mesme Artistike "Jan Kukuzeli", Durrës:**

M.Memaj, I.Caushi, A.Abdyli, A.Bilali, I Bali, I.Dyrmishi, A.Meshkurti, A. Gjyzeli, M.Copia, A.Plakalli, N.Katellari, N.Kume, K.Kaceli, Ll.Doka, E.Beqaraj, A.Petro, G.Hasani, D.Shahinaj, E Sinomati, E.Memi, L.Dhaskali, B. Gjata.

**Përgatitur nga mësuesit:**
V.Caku, M. Ikonomi, M. Kurici, A.Kaprazi, I.Çullhai, D.Mehmeti, B.Guma.

**Me pjesë nga kompozitorë:**
J.S.Bach, A.Vivaldi, Sean Sans, Postock, J.Sagreras, Mazas, Gali, Burgmuller, Pachelber.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 50 spektatorë.

## E premte, 03 maj 2013, ora 18:00





**Përurim i librit**
**të Ruzhdi Goles**
**"Kureshtje për t'u rritur"**, fitues i Çmimit Kombëtar në Letërsinë për Fëmijë në konkursin mbarëkombëtarë shpallur me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, Tiranë, Nëntor 2012.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 50 pjesëmarrës, shkrimtarë, poetë, artistë etj.

**Vepra të tjera**
Krijimtaria e pasur e tij përmendim vepra si: "Maji i Zambakëve", "Emri Yt", "Vonoj të thinjem", "Me zjarrë fërkoj duart", "Kërcimtar pa kurm", "Njerk i askujt", "Pak terr dhe etje", "Vertebra e shiut", (Antologji Vetjake), etj.





## E enjte, 09 maj 2013, ora 17:00










### Përurim i librit të Ardi Omerit me tregime dhe novela: "Udhëtari i përjetshëm"

**Pjesëmarrja:**
Mbi 40 pjesëmarrës, shkrimtarë, poetë, artistë etj.

**Krijmatira**
I munduri i natës- Poezi
Puthma shpirtin – Poezi
Skalitur me buzëshpirti – Poezi
Zhgenjimi Adamit – Poezi
Udhëtari i përjetshëm – Tregime/Novela
Puthjet e heshtura – Novelë
Puthje pa lamtumirë – Poezi

Të gjitha krijimet janë promovuar në këtë Klub Artistësh që në inagurimin. Mbështetja e kompanisë SIGAL ka qenë që edhe artistë të tjerë durrsakë por edhe të qyteteve të tjera të Shqipërisë dhe Kosovës e kanë pas si një pikë referimi. Ardi Omeri është një krijues me frymë moderne, ku proza e tij ka një tematikë të pasur, kryesisht me probleme sociale. Omeri rrugëton në problemet jetësore, si një eksplorues, që këto probleme i nxjerrë në pah në mënyrë të sinqertë.


SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Udhëtoni të siguruar!
Me sigurimin Kasko unë jam i qetë sepse për automjetin tim kujdeset SIGAL UNIQA!

## E mërkurë, 15 maj 2013, ora 17:00





pianisten
Rudina CIKO

### Mbrëmje Artisitke me pianisten Rudina Ciko.

**Programi**
Shikimi i dokumentarit për artisten i përgatitur nga Klubi i Artit dhe i Kulturës SIGAL, "Portret artisti" nga Prof. Dr. Zana Shuteriqi dhe pjesë në piano luajtur nga pianistja Rudina Ciko, vepra të autorëve: Zadeja, List, Brans etj.
**Pjesëmarrja:**
Mbi 70 spektatorë.

U diplomua në vitin 1984 me rezultate maksimale. Prej vitit 1990 është pedagoge në Akademinë e Arteve. Ka bërë disa specializime jashtë shtetit si në Milano, Breshia, Bukuresht, etj... Repertori i saj përfshin vepra të kompozitorëve të njohur shqiptarë dhe të huaj. Është pjesëmarrëse e të gjitha Festivaleve të zhvilluara në Tiranë nga shoqatat kulturore kryeqytetase. Në vitin 2007, nderohet me çmimin "Kult", mban titullin "Profesor" nga viti 2012.






## E enjte, 16 maj 2013, ora 19:00







**Ekspozitë personale e piktores kosovare Agnesa Muharremi, me titull "Transformim III"**

**Pjesëmarrja:**
Mbi 30 pjesëmarrës, piktorë, skulptorë, nxënës e mësues të degës së artit figurativ të Shkollës se Mesme Artistike "Jan Kukuzeli" , Durrës, si dhe shikues të tjerë.

Agnesa ka marrë pjesë ën 24 ekspozita brenda dhe jashtë atdhueut të saj. Aktualisht është pedagoge e arteve pamore në fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ajo vjen nga një familje artistësh.

Në pikturat e saj bie në sy gjallimi i kozmosit, furia dhe pështjellimi i tij, krijimi dhe rikrijimi, flukse thërmiash magnetike, oqeane, stuhi dhe tarmundana. Ajo krijon planetë të bukur, ku veç në piktorë si ajo mund ti krijojë. Aty sheh shira që bien, zjarre jetsëorë që ndizen në emër të lirisë.









## E shtunë, 18 maj 2013, ora 19:00









**Festivali "Pranverë poetike durrsake"**

Përgatitur nga Klubi i shkrimtarëve dhe artistëve durrsak.

**Programi:**

Promovimi i librit "Triumfi i Kombit", Skënder Kapiti.

Konkurs poetik me poetët: A.Kadolli, A.Mato, E.Agolli, A.Zaplluzha, A.Bajrami A.Themiu, A.Begaj, A.Omeri, A.Ballgjini, B.Agasi, B.Neziri, F. Brovina, Sh. Galica, S. Rustemi, F. Musaj, L. Ramushi, Xh. Cirongu, E. Kacanja, M. Thartori etj.

Evidentimi dhe promovimi i krijimtarisë poetike të autorëve durrsak. Krijimi i lidhjeve dhe këmbi i eksperiencave krijuese. Krijimi i miqësive dhe binjakëzimi me klubet poetike në Shqipëri, Kosovë me shqiptarët në Maqedoni dhe Mal të Zi.

**Pjesëmarrja:**

Mbi 80 pjesëmarrës, shkrimtarë, poetë nga Durrësi, Tirana e qytete të tjerë të Shqipërisë, si dhe shkrimtarë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

# WORKSHOP

**E mërkurë, 22 maj 2013, ora 09:00**







**Workshop:**
**Respektimi i kodit etik**
nga media gjatë fushatës zgjedhore parlamentare 2013, organizuar nga Shoqata e Gazetarëve Profesionistë rajonalë në bashkëpunim me Unionin e Gazetarëve Durrës, me mbështetjen e OSCE-së.

Pjesëmarrja:
Mbi 20 gazetarë dhe punonjës të medias.

Me këtë rast të pranishmëve iu shpërndanë libra mbi "Raportimi i drejtë dhe i balancuar i fushatës zgjedhore" dhe " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"





## E mërkurë, 22 maj 2013, ora 18:30







**Përurim i librit
me poezi të Viktoria Xhakos,
“Testamenti”**

**Pjesëmarrja:**
Mbi 40 shkrimtarë, poetë, artistë të profileve të ndryshme etj.

Viktoria Xhako, lindi në Durrës më 9 tetor 1950. Ka mbaruar fakultetin e Gjuhë-Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Ka punuar për nëj kohë të gjatë si mësuese e gjuhës dhe letërsisë në qytetin e Durrësit. Ka shkruar katër libra dhe vazhdon ende të krijojë.

Aktiviteti nxori në pah vlerat krijuese të një poete të njohur, eksperienca dhe vlerat e së cilës meritojnë njohje dhe nga poetët më të rinj.

Ky është një aktivitet që zgjoi interes tek ambientet letrare – artistike të qytetit Durrësit por edhe për shumë kolegë nga Tirana dhe rrethet e tjera të vendit.









## E enjte, 23 maj 2013, ora 17:00






Z./Znj. ______________________

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL

ka kënaqësinë t'ju ftojë

në një mbrëmje artistike

të përgatitur nga:
Ermira Peku, Zhiti
Aida Kazazi, Borshi

Ditën e Enjte, datë 23 Maj 2013, ora 17.00

Programi:

Violinat
1 - Ronaldo AMOLLI
- Minuet - Potolovski
- Petrushka - Brams
2 - Xhesilda ZANO
- Moderato - Gajdes
- Allegro - Bekman
3 - Armela SPAHIU
- Allegro - Kabalevski
- Allegro - Kabalevski
4 - Edvali HAFIZI
- Zefs RE + (korda III)
5 - Duet Jashinov/Amolli-Spahiu

Pianot
1 - Helena MUHO
- Vallja e leckamanit - Ponichell
- Himni i gazimit - Beethoven
- Kur shenjtorët marshojnë - kënge Amerikane
2 - Gledis MUHJA
- Danubi Blu - Shtraus
- Vallja e oreve - Ponichell
- Pjesa per 4 duar - Diabeli
3 - Igli ÇAFAJ
- Marshi i Radecidt - Shtraus
- Marshi martesor - Mendelson
- Kenge popullore Amerikane
4 - Bleada ASLLANI
- Syte e Zi - Kenge popullore ruse
- Valle Spanjolle - Muzhorvski
5 - Viola HOTI
- Lojra te adaluara - Ponichell
- Santa Lucia - Kenga napolitane
- Scherzo - Davidi i vogel - (Denis dhe Viola)
6 - Denis HOTI
- Marshi Turk - Mozart
- Habanera - Bize (opera Carmen)
7 - Dasara RUGJI
- Sonata e henes - Beethoven
- Vals - Shostakovich

Të ftuar: Motrat ELEZI
Bjorni BARDHI

Ekspozitë pikture: Juxhin ABDIU
(klasa e 8b) shkolla 9-vjecare "Marie Kaculini"

**Koncert dhe ekspozitë pikture me:**
Nxënës të violinës: R.Amolli, Xh.Zano, A.Spahiu, E.Hafizi.
Nxënës të pianos: H.Muho, G.Muhja, I.Cafai, B.Asllani, V.Hoti, D.Hoti, D.Rugji dhe nxenesi piktor Juxhin Abdiu.

**Përgatitur nga:**
Ermira Peku, Zhiti, Violine
dhe Aida Kazazi, Borshi, Piano.

**Me pjesë nga kompozitorët:**
Brams, Kabalevski, Beethoven, Shtraus, Mendelson, Mozart, Bize, Shostakovich etj.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 90 spektatorë dhe shikues.

Një edukim i mirë është investimi më i mirë jo vetëm për individët por për gjithë shoqërinë në tërësi. Gjithëpërfshirja duhet të jetë vendi ku pranimi, respekti, lehtesimi, dhe promovimi i vlerave duhet të mbizotërojë.









# MUZIKË

**E enjte, 30 maj 2013, ora 18:00**






**Koncert i Ansamblit të Dhomës Barok i Universitetit të Arteve, Tiranë**
Udhëheqës i ansamblit:
Lektor Miron Peku.
Studentët: B. Koka - violinë, A. Meta - violinë, F. Gjeli - violinë, A. Karaj - violinë, M. Kovaci - violinë, E. Nako - v/cello, E. Novaku - c/basso, L. Gjeci - Piano/cembalo.
Me vepra nga konpozitorët: A.Vivaldi, G.F. Handel, G.F. Telemann.
**Pjesëmarrja:**
Mbi 50 spektatorë.
Formacioni Barok i krijuar këtë vit akademik 2012-2013 në U. Arteve Tiranë, me qëllimin artistik të lëvrimit të muzikës barok të artëdashësit tanë. Muzika Barok, me stilin e saj të veccantë të intepretimit, është një risi duke i zbërthyer veprat si nga pikpamja e veccantë solfezhike me elementë të veccantë si trili, mardenti, vibrato si dhe vendosja dhe prodhimi i tingullit me harkun specifik të kësaj muzike. Kjo u realizua me sukses në veprat e Vivaldit Telemann, Hendel në sallen e Klubit të Arteve të Kulturës SIGAL –Durrës dhe u mirëprit me shumë kënaqësi.






# WORKSHOP

**E hënë, 03 qershor 2013, ora 09:30**

**Mbledhje e organizuar nga "Shoqata e Gruas", me tematikë të trajtuar rreth "Mendimit për veten në lidhje me grupin dhe sa grupi është i konsoliduar".**

**Përgatituar nga: Bajana Ceveli**

**Programi:**

Mirëseardhja, loja e hapjes, punë në grup (sa i konsoliduar është grupi), pushim kafe, prezantim, diskutime, vlerësim ditor, loja e mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.





# WORKSHOP

**E martë, 04 qershor 2013, ora 09:30**

**Mbledhje e organizuar nga "Shoqata e Gruas" me tematikë të trajtuar "Finalizimi i Planit Individual të Zhvillimit".**

**Përgatituar nga: Bajana Ceveli**

**Programi:**

Loja e hapjes, rikthim te PIZH-I dhe diskutimi final i tyre, pushim kafe, vlerësim i ditës, loja e mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.





## E enjte, 06 qershor 2013, ora 19:00






**Koncert Recital i nxënësve të Shkollës së Mesme rtistike "Jan Kukuzeli", Durrës dhe i studentëve të Universitetit të Arteve, Tiranë:**
D. Shahinaj, A.Plakalli, Dh.Daka, I.Dyrmishi, A.Qela, R.Jubi, A.Hoxha, D.Asllani.
Përgatitur nga:
Pedagogu i kitarës Altin Tila.
Me pjesë nga kompozitorë:
Çajkovski, P.Roch, E. Perosino, S.Abreu etj.
**Pjesëmarrja:**
Mbi 80 pektatorë.
Në këtë performancë të nxënësve të shkollës së muziks " Jan Kukuzeli" dhe e studentëve të Universitetit të Arteve, Tiranë pedagogu i tyre Altin Tila kishte për qëllim të gërshetonte me pasion e profesionalizem talentet e nxënësve dhe studentëve në një program artistik ku performanca e kitaristëve shpalosi emocione të repertorit klasik latin modern me një nivel të lartë interpretativ. Ky program artistik është performuar dhe në qytetet e tjera si në Shkodër, Tiranë, Vlorë,Korccë dhe në festivalin e kitarës i mbajtur në Prishtinë.
Qershor 2013








SIGAL

## E premte, 07 qershor 2013, ora 18:00







**Koncert & ekspozitë pikture nga artistët e vegjël nga kurset `Madi`**

**Përgatitur nga:**
Klea Zhonga Gjezi, Piano
Kosta Zhonga Piktor

**Programi:**
Pjesë nga kompozitorët Beethoven, Beyer, Cerni, si dhe 78 punime pikture nga piktorë të vegjël.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 100 spektatorë.

**Klea Zhonga Gjesi,** pianiste, mbaroi në vitin 1989 Akademinë e Arteve. Ka ndjekur master class për piano në Athinë. Ka nëj ëprvojë 20-vjeccare si instrumentiste dhe pedagoge pianoje.

**Kosta Zhonga,** piktor. Përfundoi Akademinë e Arteve në vitin 1988. Menjëherë pas përfundimit të studimeve ka punuar si piktor pranë Shtëpisë Botuese së librit. Aktualisht drejton emisione televizive.








# WORKSHOP

**E mërkurë, 12 Qershorë 2013, ora 09:30**

**Mbledhje e organizuar nga “Shoqata e Gruas”, me tematikë të trajtuar “Lehtësimi dhe qartësimi i mëtejshëm mbi aktivitetin që do të zhvillohet me grupet e Elbasanit, si dhe përcaktimi i elementeve të nevojshme për organizimin e aktivitetit”.**

**Përgatitur nga: Bajana Ceveli**

**Programi:**
Mirëseardhja, loja e hapjes, përfshirja sociale, diskutimi dhe risjellja në vëmendje e tyre të aktivitetit që do të zhvillohet me këshilltarët e Elbasanit, vlerësim dite, loja e mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesmarrës.






SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Shëndeti vjen i pari!
Sigurimi Privat i Shëndetit
mbulon shpenzimet mjekësore,
kudo, në çdo kohë.

# ART FIGURATIV

**E mërkurë, 12 Qershorë 2013, ora 19:00**







**Ekspozitë e piktorit**
**Vasil Lalo**

U ekspozuan 32 piktura të përzgjedhura e të përgatitur gjatë jetës së tij.

**Pjesëmarrja:**
**Mbi 50 artistë dhe artdashës.**

**Vasil Lalo** lindi në Radovë të Leskobikut, më 8 Mars 1933. Studimet I përfundoi në degën e skulpturës në vitin 1953. Gjatë këtyre viteve ai studioi dhe punoi me artistë dhe profesorë të shquar si; Janaq Pacco, Odise Paskali, Sadik Kaceli, Nexhmedin Zajmi dhe Abdurrahim Buza. Ka marrë pjesë ën shumë ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Gjermani, Kanada, Turqi, Greqi Maqedoni. Shumë piktura të tij zbukurojnë ambientet e Ambasadës Shqiptarë në Gjermani dhe Amerikë.









## E enjte, 13 qershor 2013, ora 19:00






**Koncert Recital**
**i instrumentistëve të Universitetit të Arteve, Tiranë:**
Armir Xhakoviq- piano
Redis Mujaj- vilolinë

**Programi:**
W.A.Mozart, Sonatë për piano nr.6 k 332 në F major,
L.V.Beethoven, Sonatë nr. 7, piano-violinë,
Bela Bartok, Rumanian Folk Danses, violinë-piano
**Pjesëmarrja:**
Mbi 70 spektatorë.

**Armir Xhakoviq, pianist.**
Në vitin 2007 diplomohet me notë maksimale në Mal të Zi. Gjatë viteve 2008-09, mer mësime në Beograd.

**Redis Mujaj, violinist.**
Mbaron studimet e larta në Akademinë e Arteve. Aktualisht është student në vitin e dytë master.
Ky koncert ishte një përvojë e re për nxënësit e muzikës dhe pedagogët e shkollës së muzikës.








UNIQA

WORKSHOP

**E premte, 14 qershor 2013, ora 09:30**

**Mbledhje e organizuar nga "Shoqata e Gruas" me tematikë të trajtuar rreth "Shkëmbimit të ideve dhe zgjedhjeve rreth vështirësive që hasen në punë. Rritja e besueshmërisë së pjesëmarrësve për sa i përket përballimit të vështirësive".**

**Përgatituar nga:** Bajana Ceveli

**Programi:**
Mirëseardhja, loja e hapjes, brainstorming rreth vështirësive që hasen gjatë punës dhe si mund t`i zgjidhim ato, vlerësim dite, film room, loja mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesmarrës.






SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Për një pleqëri të garantuar!
Tek SIGAL UNIQA ne kemi zgjedhur vetë vlerën e pensionit që marrim!

## E premte, 14 qershor 2013, ora 19:00






Z./Znj. ____________________

KLUBI I ARTIT DHE KULTURES SIGAL
ka kënaqësisë t'Ju ftojë
në koncertin recital

të nxënësve të Shkollës së Mesme Artistike
"Jan Kukuzeli", Durrës, Klasa e Violinës

të ideuar & përgatitur nga pedagogu:
Arben Diko

Shoqëron në piano:
Mirela Xhaferraj

Ditën e Premte, 14 Qershor 2013, ora 19:00

PROGRAMI

| | |
|---|---|
| Negis Deliallisi- | Moxart, "Alegro" |
| Goldberg Kurti- | Bethoven, "Urithi" |
| Sarah Dika- | Bethoven, "Lulja e bukur" |
| Paula Paço- | Hendel Gavote, "Temë me varia cione" |
| Mario Setja- | P. Gaci, "Nina Nana" |
| Anisa Sali- | Akolaj, "Koncert" |
| Xhesi Byci- | Rode, "Koncert" Koha 3 |
| Rigels Ushina- | Moxart, "Koncert" La +Koha 1 |
| Ronald Deda- | N. Paganini, "Kapric Nr. 21"<br>E. Lalo, "Koncert" Koha I |

**Koncert Recital i nxënësve të Shkollës së Mesme Artistike "Jan Kukuzeli", Durrës.**
N. Deljallisi, G.Kurti, S.Dika, P.Pacio, M.Sedja, A.Sali, Xh.Byci, R.Ushina, R.Deda.

**Me pjesë nga konpozitorët:**
Mozart, Beethoven, Hendel, Akoli, Rode, N.Paganini,

**Përgatitur nga:**
Mësues I Violines Arben Diko, Shoqeron ne piano, Mirela Xhaferaj

**Pjesëmarrja:**
Mbi 60 spektatorë.

Koncert me nxënësit më të mirë, për të evidentuar arritjet më të mira. Qëllimi është nxitja e nxënësve për të përparuar më tej me rrugëtimin e tyre të vështirë të violinës. Ballafaqimi me skenën është një shtysë e madhe në punën e tyre, pasi përccon një përvojë te re të domosdoshme për ecurinë në rrugën e bukur ët artit të muzikës.






SIGAL



# WORKSHOP

**E hënë, 17 qershor 2013, ora 09:30**

**Mbledhje e organizuar nga "Shoqata e Gruas", me tematikë të trajtuar "Vështirësitë dhe sfidat që hasin komuniteti Rom dhe menaxhimi i tyre".**

**Përgatituar nga: Bajana Ceveli**

**Programi:**
Mirëseardhja, loja e hapjes, punë në grupe (problemet që hasin komuniteti Rom), pushim për kafe, prezantime, vlerësim  dite, loja e mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.





# TRAJMIN

**E martë, 18 qershor 2013, ora 09:30**

**Trajnim nga Banka Botërore në bashkëpunim me "Shoqatën e Gruas".**

Qëllimi i këtij trajnimi ishte mësimi i të rinjë për plotësimin e një Plani Biznesi. Angazhimi i të rinjve dhe i ideve të tyre në lidhje me hapjen e një biznesi të vogël.

Në fund do të shpallen fituesit e këtij trajnimi dhe plani i biznesit fitues do të konkretizohet duke u financuar nga Banka Botërore.

**Përgatituar nga:**
Banka Botërore në bashkëpunim me "Shoqatën e Gruas".

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.





# TRAJNIM

**E mërkurë, 19 qershor 2013, ora 09:30**

**Trajnim nga Banka Botërore në bashkëpunim me "Shoqatën e Gruas".**

Qëllimi i këtij trajnimi ishte mësimi i të rinjë për plotësimin e një Plani Biznesi. Angazhimi i të rinjve dhe i ideve të tyre në lidhje me hapjen e një biznesi të vogël. Në fund do të shpallen fituesit e këtij trajnimi dhe plani i biznesit fitues do të konkretizohet duke u financuar nga Banka Botërore.

**Përgatituar nga:**
**Banka Botërore në bashkëpunim me "Shoqatën e Gruas".**

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.






SIGAL
UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Jepini fëmijës suaj avantazhe në jetë!
Me Kasa për Fëmijë mund ti siguroni të ardhmen fëmijës suaj!

**E mërkurë, 19 qershor 2013, ora 18:00**

**Koncert Instrumental -Vokal i nxenesve te Shkollës së Mesme Artistike "Jan Kukuzeli", Durrës (klasa e pianos dhe e kantos):**

E.Reka, K.Shabani, F.Dedja, E.Muzhja, F.Likja, E.Lika, R.Sinella.

**Përgatitur nga mësuesit:**
Flavia Dyrmishi dhe Ardian Kamberi.

**Me Vepra nga:**
T. Harapi, V. Nova, L. Dizdari, Shubert, J.S.Bach, A.Scarlati, Chopin, Hendel, Çimarosa, Çajkovski.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 70 spektatorë.





# MUZIKË

**E enjte, 20 qershor 2013, ora 17:00**

**Mbrëmje koncertale me fëmijët e kopshtit "Winnie the Pooh",**
me rastin e kalimit të disa fëmijëve në ciklin e ulët shkollor.

**Programi:**
Rituale fëminore , me këngë shqip dhe anglisht, valle popullore, pjesë në piano etj, të ekzekutuara nga fëmijët e kopshtit, në drejtimin e edukatores.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 60 prindër dhe të afërm të fëmijëve.






## E enjte, 20 qershor 2013, ora 19:00

**Koncert Recital i te rijve nga kurset e kitares dhe pianos.**
A.Dako, A.Hasabelliu, N.Hasabelliu, Q.Hasabelliu, R. Hasabelliu.
Organizuar me rastin e mbylljes së vitit shkollor 2012-2013.
**Përgatitur nga pedagoget:**
Panajota Hoxha – Piano dhe Altin Tila - Kitare.
**Programi:**
Bach, Mozart, Shubert, Çajkovski, Brahms, Beethoven etj.
**Pjesëmarrja:**
**Mbi 70 spektatorë.**

Në këtë koncert u evidentuan talentet e reja të cilët interpretuan në nivel të lartë muzikorë programin që kishin përgatitur me pasion e seriozitet.






# WORKSHOP

**E premte, 21 qershor 2013, ora 14:30**

**Mbledhje e organizuar nga "Shoqata e Gruas", me tematikë të trajtuar "Vështirësive që ka hasur komuniteti Rom dhe nxitja e tyre për të vazhduar përpara".**

**Përgatituar nga: Bajana Ceveli**

**Programi:**
Mirëseardhja, loja e hapjes, shfaqa e një dokumentari rreth Holokaustit, pushim kafe, diskutime, vlerësimi i ditës, loja e mbylljes.

**Pjesëmarrja:**
Mbi 15 pjesëmarrës.



## E hënë, 01 korrik 2013, ora 19:00

**Koncert Recital i të rinjve nga kurset e kitarës të mësuesit Altin Tila dhe mësueses së pianos Panajota Hoxha, me rastin e mbylljes së vitit mësimor 2012-2013.**

E.Hoxha, R.Haxhiu, B.Shaba, A.Qela, K.Tanga, F.Dervishi, D.Serani, Ll.Daka, K.Ngresi, R.Gitani, F.Ora, K.Hoxha.

**Programi:** Pjesë në piano dhe kitarë si këngë për fëmijë dhe këngë ruse, pjesë shqiptare, dy valse etj.

**Pjesëmarrja:** Mbi 80 prindër, të afërt dhe spektatorë të ndryshëm.

Ky koncert paraqet një program të larmishëm nga autorë të ndryshëm klasik e modern. Performanca shumë e mirë e nxënësve u prit me duartrokitje të shumta. Vlen për tu përmendur përshtatja e disa pjesëve për kitare e piano nga pedagogu Altin Tila.






# MUZIKË

## E enjte, 04 korrik 2013, ora 18:00

**Koncert Recital i nxënësve të kursit te violines dhe kitares.**
E.Ndreu, K.Çopja, D.Cara, E.Limanaj, T.Kallço, K.Qerama, S.Cako, G.Çefa,V.Gashi, N.Tereziu, S.Iuku.

**Pergatitur nga:** Mësuese e violinës Nevila Kalaja, dhe Eduart Tereziu Kitare.

**Programi:** G.Aguado, Scorpions, Spanish Danc, Animals, p.Gaci, Brams, Moxart, Vivaldi etj.

**Pjesëmarrja:**Mbi 80 spektatorë.






# TRAJNIM

**E enjte, 18 korrik 2013, ora 09:30**

**Shoqata Save the Children me drejtuese Anila Alliu**
**Tema e trajnimit:Trafikimi i Fëmijëve dhe Migrimi i Sigurt**
**Marrë nga bitim i SCIA, Manual për Drejtuesit e bashkëmoshatarëve – Tema4**

**Programi**

09:30 – 09:45 Tema e trajnimit, Qëllimi + Prezantimi
09:45 – 10:15 Lojë në grup => Misioni i pamundur -
10:15 – 11:15 Çfarë është migrimi?
- Faktorët shtytës dhe tërheqës të migrimit
- Qartësim i terminologjisë në lidhje me migrimin dhe trafikimin

11:15 – 11:30 Coffee Break
11:30 – 11:50 Aktivitet 1 – Hyrje në konceptin e Migrimit të Sigurt
Punë në grup, diskutim, prezantim
11:50 – 12:50 Aktivitet 2 – Marrja e vendimeve të informuara
Lojë me role
12:50 – 13:50 Dreka
13:50 – 14:00 LOJË: Sallata e Frutave
14:00 – 15:00 Njohuri të përgjithshme mbi fenomenin e trafikimit
- Fazat dhe Rreziqet e trafikimit
- Të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve në fushën e migrimit
- Si mund ta mbrojmë veten?

15:00 – 15:30 Shfaqjen e videove apo spoteve të ndryshme me temën e trafikimit
15:30 – 16:30 Legjislacioni Shqiptar
Kuadri ligjor / Parimet themelore / Lufta kundër emigrimit të parregullt / Zgjerimi i migracionit rregullt / Mbështetja e emigrantëve jashtë / Detyrimet e emigrantit / Kthimi dhe riintegrimi / Parimet që duhen respektuar gjatë kthimit / Proçedurat – Ripranimi

**Pjesëmarrja:** **M**bi 50 nxënës.

# TRAJNIM

**E premte, 19 korrik 2013, ora 09:30**

**Shoqata Save the Children me drejtuese Anila Alliu**
